

Banka e Shqipërisë

Një guidë drejt
llogarisë tuaj të parë
bankare

2008

PËRMBAJTJA

Përse
ju
duhet
llogaria
bankare?
Fq.4

Cila
llogari
i
përshtatet
më mirë
nevojave tuaja
financiare?
Fq.5

Pyetje
që
duhet të
bëni përpara
se të hapni një
llogari bankare
Fq.7

Ç'duhet
të bëni
për të
hapur
llogarinë
e duhur
bankare?
Fq.6

Si të
kujdeseni
për
llogarinë
tuaj?
Fq.8

Çfarë është
overdraft-i?
Fq.9

Ende
keni
dysime?
Fq.11

Si të zhvilloni
lidhjen tuaj
me bankën?
Fq.10

Botime
edukative
të
Bankës së
Shqipërisë
Fq.12

PËRSE JU DUHET LLOGARIA BANKARE?

Hapja e një llogarie bankare është pjesë e jetës së përditshme. Është një veprim që duhet kryer nga të gjithë, që në momentin kur fillojmë të përfitojmë të ardhurat tona. Në këtë mënyrë do të kurseni energji dhe në të njëjtën kohë do të keni mundësi të shtoni kursimet tuaja. Me anë të një llogarie bankare ju:

Ruani paratë tuaja nga humbja apo vjedhja;

Kryeni pagesa të ndryshme duke kursyer kohë;

Kontrolloni në çdo kohë të gjitha veprimet tuaja financiare;

Rrisni kursimet nëpërmjet marrjes së interesave;

Mund të merrni një kredi.

Ju duhet të ndiheni të sigurt duke besuar kursimet tuaja në një llogari bankare. Agjencia e Sigurimit të Depozitave me qendër në Tiranë, siguron depozitat e klientëve që mbajnë kursimet e tyre në bankat tregtare. Bankat tregtare mbikëqyren rregullisht prej Bankës së Shqipërisë, bankës qendrore të Republikës së Shqipërisë, e cila i licencon këto subjekte për kryerjen e aktivitetit bankar.

CILA LLOGARI I PËRSHTATET MË MIRË NEVOJAVE TUAJA FINANCIARE?

Kjo varet nga qëllimi se për çfarë do ta përdorni llogarinë tuaj. Në qoftë se keni si synim të shtoni kursimet tuaja, ju duhet të hapni një llogari kursimi (depozitë me afat). Bankat tregtare ofrojnë llogari depozite me afat, llogari kursimi dhe llogari rrjedhëse, si dhe produkte të tjera bankare që plotësojnë nevojat e konsumatorit. Në varësi të kërkesave të këtij të fundit, bankat kanë krijuar dhe produktet përkatëse. Në rast se individët kanë nevojë të kryejnë pagesa të ndryshme, atëherë iu vjen në ndihmë llogaria rrjedhëse. Në rast se janë të prirur që disa kursime të tyre mos t'i përdorin për një kohë relativisht të gjatë, atëherë iu vjen në ndihmë depozita me afat. Nëpërmjet kësaj, mund të përfitojnë edhe interesa mbi kursimet e tyre.

Ndërsa llogaritë e kursimit janë llogari që kanë karakteristika të përbashkëta me dy të tjerat: mund të shërbejnë dhe si mjet pagese dhe si mjet "investimi".


Llogaritë rrjedhëse

përdoren për të tërhequr në mënyrë të shpeshtë paratë tuaja në bankë. Ato janë shumë të përshtatshme për përdorim të përditshëm si për shembull për të depozituar, për të paguar fatura të ndryshme, për t'u dërguar para të afërmve, për të tërhequr rrogën, kredinë, për transferta automatike ndaj të tretëve (qira) etj.. Interesi që paguhet për këtë lloj llogarie ndryshon sipas bankave. Sigurohuni të zgjidhni bankën që ju ofron kushtet e llogarisë, e cila plotëson më së miri nevojat tuaja.

Llogaritë e kursimit

janë një mënyrë për të shtuar kursimet tuaja në të ardhmen. Për përdorimin e kësaj llogarie banka ju ofron interes mbi shumën e kursyer. Me anë të llogarisë së kursimit ju mund të tërhiqni paratë tuaja por në mënyrë të kufizuar, në kohë ose në sasi. Kur hapni një llogari kursimi, disa banka ju pajisin me një librezë kursimi në të cilën shënohen të gjitha depozitimet apo tërheqjet tuaja. Llogaria e kursimit nuk ka minimum të nevojshëm, pra mund të qëndrojë e hapur edhe nëse balanca është zero.

Ç'DUHET TË BËNI PËR TË HAPUR LLOGARINË E DUHUR BANKARE?



Sigurohuni që të keni gjithë informacionin lidhur me dokumentet e identifikimit që ju duhen, për të hapur një llogari bankare. Një kusht për hapjen e llogarisë është mosha 18 vjeç. Për personat nën këtë moshë, llogaria mund të hapet prej prindit ose kujdestarit.

Përpara se të hapni një llogari për qëllim të përfitimit të një kredie, të gjitha bankat do t'iu kërkojnë leje për të kontrolluar marrëdhëniet tuaja me bankat e tjera.

Një llogari bankare mund të jetë në pronësi të një individi ose të disa individëve së bashku. Për të përdorur llogarinë bankare duhet paraqitur një dokument identifikimi. Shumë prej bankave pranojnë edhe një patentë, një fotokopje të pasaportës ose një certifikatë personale.

PYETJE QË DUHET TË BËNI PËRPARA SE TË HAPNI NJË LLOGARI BANKARE

1.

A ju duhet të paguani një shumë të caktuar çdo muaj për mirëmbajtjen e kësaj llogarie? Nëse po, sa kushton ajo?

2.

A ka një shumë minimale që ju duhet të lini brenda llogarisë? Nëse po, sa është ky minimum? Sa është komisioni që duhet të paguani në qoftë se e kaloni këtë kufi?

3.

Sa është përqindja e interesit të llogarisë që dëshironi të hapni? (Përqindjet e interesit të depozitës që dëshironi të hapni ndryshojnë në varësi të monedhës me të cilën dëshironi të hapni llogarinë tuaj. Kështu, nëse llogarinë bankare do ta hapni në lekë do të keni një përqindje interesi të ndryshme në krahasim me një llogari e cila mund të hapet në euro apo në dollarë.)

4.

A është e kufizuar shuma që mund të tërhiqni çdo muaj? Në qoftë se po, sa është kufiri maksimal?

5.

Ku mund të tërhiqni para pa qenë nevoja të paguani interes? Sa është përqindja e interesit të përdorimit të një ATM_je të një banke tjetër?

Përveç këtyre pyetjeve, mos hezitoni të sqaroheni për çdo paqartësi që mund të keni. Për t'ju ardhur në ndihmë, është më mirë të keni një person kontakti në bankë që mund t'ju informojë rregullisht. Është shumë më e lehtë kur flisni me dikë që e njihni.

SI TË KUJDESENI PËR LLOGARINË TUAJ?

Për të administruar sa më mirë paratë tuaja, ju duhet të shmangni probleme të ndryshme me llogarinë bankare. Për këtë, personat që mund të përdorin llogarinë tuaj duhet të jenë regjistruar dhe indentifikuar paraprakisht në bankë. Në të kundërt, banka nuk do të jetë në gjendje t'ju mbrojë nga falsifikimet apo vjedhjet që persona të pidentifikuar mund të kryejnë me llogarinë tuaj. Kujdesuni që llogaria juaj të mos keqpërdorohet nga individë të paautorizuar.

**Kujdesuni që llogaria
juaj të mos keqpërdorohet
nga individë të paautorizuar!**


ÇFARË ËSHTË OVERDRAFT-I?

Duhet të jeni të kujdesshëm në përdorimin e paradhënies bankare. Paradhënia bankare ose shpesh herë e quajtur *overdraft*, është një mundësi për të kryer shpenzime të menjëhershme, më të larta se sa gjendja e llogarisë tuaj. Menjëherë pasi të keni tërhequr paradhënien bankare nga llogaria juaj, bilanci në llogari do të rezultojë në minus, derisa ju të keni shlyer të gjithë shumën që keni tërhequr. Për paradhënien bankare duhet të nënshkruani një marrëveshje paraprake me bankën, në të cilën ju autorizohet shuma dhe interesi që aplikohet mbi të.

Paradhënia bankare ose shpesh herë e quajtur *overdraft*, është një mundësi për të kryer shpenzime të menjëhershme, më të larta se sa gjendja e llogarisë tuaj.

SI TË ZHVILLONI LIDHJEN TUAJ ME BANKËN?

Llogaria juaj është hapi i parë i krijimit të një lidhjeje ndërmjet jush dhe bankës. Kjo lidhje ju jep mundësi të administroni paratë tuaja, duke kursyer për të ardhmen dhe shtuar fitimet. Përveç këtij shërbimi bazë, bankat tregtare ofrojnë produkte dhe shërbime të tjera si:



ENDE KENI DYSHIME?

“Nuk ndihem i qetë kur hyj në një bankë...”

“Nuk ndihem i qetë kur hyj në një bankë...” Disa banka janë më tërheqëse në krahasim me disa të tjera. Këshillohuni me një shok të ngushtë apo me një pjesëtar të familjes, i cili tashmë ka një llogari bankare. Ndoshta ata mund t’ju shoqërojnë për në bankë apo t’ju prezantojnë me një përfaqësues të bankës.

“Dua që informacioni i llogarisë time bankare të njihet vetëm prej meje...” Çdo bankë ka për detyrë të ruajë konfidencialitetin lidhur me informacionin tuaj personal. Sigurohuni që edhe ju vetë ta mbron “intimitetin” e llogarisë tuaj bankare, duke mos lejuar asnjë person të paautorizuar të përdorë llogarinë tuaj.

Dua që informacioni i llogarisë time bankare të njihet vetëm prej meje...

“Jam përpjekur të hap një llogari bankare dikur dhe nuk munda...” Të mirat që sjell hapja e një llogarie bankare ia vlejnë që ta provoni edhe një herë tjetër. Kur shkoni në një bankë e cila ka personelin dhe produktet e duhura që plotësojnë nevojat tuaja financiare, jeta juaj do të ndryshojë në mënyrë pozitive.

Jam përpjekur të hap një llogari bankare dikur dhe nuk munda...

Botime edukative të Bankës së Shqipërisë

Duke e konsideruar publikun si një hallkë të rëndësishme në procesin e përcimit të vendimeve të saj, Banka e Shqipërisë përgatit një sërë botimesh edukative me tema të ndryshme, disa prej të cilave po i rendisim:

Banka e Shqipërisë - Banka jonë qendrore

Nëpërmjet një panorame të përgjithshme të historisë, strukturës dhe funksioneve të bankës qendrore, kjo broshurë i prezanton publikut Bankën e Shqipërisë. Si e realizon Banka e Shqipërisë objektivin e stabilitetit të çmimeve, si kontribuon ajo, me politikat e saj, në zhvillimin ekonomik dhe në mirëqenien e vendit dhe të tjerave si këto pyetje, do t'u jepet përgjigje duke shfletuar këtë botim.

Paraja elektronike: e ardhmja e parasë?

Modernizimi i sistemit bankar ofron mundësi të shumta për mënjanimin e përdorimit të parasë cash. Një prej këtyre mundësive është përdorimi i parasë elektronike. Për të krijuar një ide më të qartë mbi këtë mundësi, Banka e Shqipërisë i ofron të gjithë përdoruesve të cash-it informacion bazë mbi këtë formë të re të parasë, avantazhet, disavantazhet e saj dhe mënyrat e ndryshme të përdorimit.

Borxhi dhe kredia = një çështje interesi

Borxhi ka ekzistuar që në kohët e mesjetës dhe deri në ditët tona. Ai ka marrë forma të ndryshme duke u zhvilluar në atë që ne e njohim sot me emrin kredi. Kjo broshurë informon publikun mbi format e ndryshme të kredive dhe si mund të aplikohet për një të tillë.

Në pritje të regjistrit të kredive

Duke pritur që edhe Shqipëria të ketë Regjistrin e saj të parë të Kredive, Banka e Shqipërisë publikon këtë broshurë, e cila synon t'i shpjegojë publikut se çfarë është një regjistër kredie, si funksionon ai, ç'loj informacioni përmban dhe mbi të gjitha përse krijimi i tij është një domosdoshmëri për situatën aktuale shqiptare.

Departamentet në Bankën e Shqipërisë

"Departamentet në Bankën e Shqipërisë" i ribotuar, ju sjell

informacion të rinovuar mbi disa ndryshime të bëra në Bankën e Shqipërisë, ndërkohë që risjell në vëmendjen e të gjithëve, një prezantim të bërë edhe më parë mbi detyrat dhe funksionet tashmë të konsoliduara, të pjesës tjetër të Bankës.

Përse duhet të keni një buxhet personal?

Buxheti mund të konsiderohet si hapi i parë për të arritur qëllimet tuaja financiare. Ai ju ndihmon të kontrolloni shpenzimet tuaja, duke krijuar mundësi që të shtoni kursimet. Në një lloj mënyre buxheti është ndërgjegja juaj financiare. Ai tregon se sa fitoni dhe sa jeni duke shpenzuar.

Bankat qendrore të rajonit

Nëpërmjet një rrëfimi copëzash të historive të bankave të rajonit tonë, kjo broshurë synon të japë një panoramë të përgjithshme të asaj çka bën një bankë qendrore. Bankat janë si njerëzit: kanë jetët dhe historitë e tyre tipike, kuriozitetet, të thënat e të pathënat, rriten, ndryshojnë, transformohen, zhvillohen, kanë veçoritë e tyre që i dallojnë nga njëra-tjetra, por në thelb mbeten të njëjta.

Ç'është për ju stabiliteti i çmimeve?

Kjo broshurë përshkruan në mënyrë të thjeshtë dhe të detajuar qëndrueshmërinë e çmimeve dhe rëndësinë e saj për ekonominë e një vendi. Në tekst, do të gjeni shembuj të cilët janë marrë nga jeta e përditshme. Kjo broshurë shpjegon edhe konceptet e inflacionit e të deflacionit dhe ndërlikimet që ato sjellin në jetën e secilit.

Bankat në epokën e internetit

Internet banking ose mundësia e përdorimit të shërbimeve bankare nëpërmjet internetit, ka sjellë pa dyshim një evolucion në sistemin bankar. Ai ka bërë të mundur "krijimin" e një filiali banke në shtëpinë e gjithsecilit. Në Shqipëri, internet banking është akoma në hapat e tij të parë. Kjo është një arsye më shumë, përse Banka e Shqipërisë ka përgatitur botimin, nëpërmjet të cilit përpiqet të prezantojë këtë shërbim; përparësitë që ai ofron dhe kujdesin e veçantë që duhet treguar gjatë përdorimit të tij.

ABC-ja e normave të interesit

Normat e interesit kanë fuqinë të ndikojnë jetët e njerëzve: sa dëshirë kanë njerëzit të kursejnë dhe sa interes kanë bizneset

të investojnë? Duke ndikuar vendimet ekonomike që personat e ndryshëm ndërmarrin, ato shërbejnë si faktor përcaktues për investimet në nivelin e përgjithshëm të ekonomisë. Përse rriten ose ulen normat e interesit? Përse disa norma interesi janë më të larta ose më të ulëta se disa të tjera?

Godina e Bankës së Shqipërisë

Kjo broshurë bën një përshkrim të godinës së Bankës së Shqipërisë. Historisë së ndërtimit të saj. Jetës dhe punës së arkitektit që e ka projektuar. Godina është rreth 70-vjeçare. E vendosur në qendër të Tiranës, ajo është një ndër ndërtesat simbol të kryeqytetit. Së shpejti, godina do të jetë objekt i një rregullimi e rinovimi të përgjithshëm. Kjo do të synojë ta shndërrojë në një ambient pune të përshtatshëm e komod për personelin e Bankës, pa cënuar identitetin dhe vlerat e saj arkitekturore.

Ndërtoni të ardhmen - Planifikoni të ardhurat tuaja

Ky libër është ideuar dhe shkruar për t'i ardhur në ndihmë publikut të gjerë në organizimin financiar të jetës së përditshme; në administrimin sa më të mirë të të ardhurave personale; në orientimin drejt mënyrave më të përshtatshme për të shtuar kursimet e tij apo për të rritur fitimet.

Çfarë është raporti për kredimarrësin?

Nga data 3 janar 2008, në Bankën e Shqipërisë filloi funksionimin Regjistri i Kredive, si baza elektronike e të dhënave për kredimarrësit e sistemit bankar. Kjo broshurë prezanton publikun me produktin kryesor të gjeneruar nga Regjistri i Kredive, që është Raporti për Kredimarrësin. Një raport i tillë përmban informacion financiar mbi individët apo personat juridikë që kanë aplikuar për kredi në sektorin bankar dhe në këtë mënyrë, ndihmon bankat të marrin vendime më të mira në lidhje me kredidhënien.

Për përgatitjen e këtij materiali jemi referuar në faqet e internetit të bankave tregtare që operojnë në Shqipëri. Për informacion më të zgjeruar rreth këtyre bankave, ju lutemi të vizitoni faqen tonë të internetit
[www.bankofalbania.org/të tjera/lidhje](http://www.bankofalbania.org/të_tjera/lidhje)
ose
kontaktoni në

public  [@bankofalbania.org](mailto:public@bankofalbania.org)

Këtë publikim mund ta gjeni edhe në
formë elektronike në adresën:

www.bankofalbania.org

Në qoftë se dëshironi të keni kopje të shkruara
të tij mund t'i kërkonit në adresën:

Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej"
Nr.1 Tiranë, Shqipëri,

Tel.: +355-(0)4-222152;

Faks: +355-(0)4-223558

ose duke dërguar një e-mail në adresën:

public  [bankofalbania.org](mailto:public@bankofalbania.org)

Tirazhi: 10000 kopje